

PËR SHPREHJE INTERESI PËR EMËRIM KRYESISHT ANETAR OSE SEKRETAR I KQV-se

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, shpall kërkesën për shprehje interesi nga shtetas për t'u emëruar kryesisht anëtarë apo sekretarë të Komisioneve të Qendrave të Votimit për zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 30.06.2019.

Kriteret që duhet të plotësojnë aplikantët:

1. gëzojnë të drejtën për të qenë zgjedhës;
2. kanë të paktën arsimin e mesëm;
3. të mos jenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
4. të mos jenë deputetë ose kandidatë për deputetë në Kuvend;
5. të mos jenë kandidatë ose të zgjedhur në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore;
6. të mos jenë/kenë me ndonjërin nga kandidatët që konkurron në zonën zgjedhore përkatëse:
 - marrëdhënie pune;
 - marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të dytë;
7. të mos kenë marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme (në rast se kanë qenë komisionerë zgjedhorë);
8. të mos jenë ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit, ose të Shërbimit Informativ Shtetëror;
9. të mos jenë anëtarë apo sekretarë të KZAZ-ve, apo të propozuar nga parti politike për anëtarë apo sekretarë të KQV-ve;
10. të mos kenë qenë të zgjedhur në strukturat drejtuese të ndonjë partie politike në 5 vitet e fundit.

Aplikimi:

Shtetasit e interesuar për t'u emëruar kryesisht anëtarë apo sekretarë të KQV-ve, të paraqesin Brenda datës **3 Qershor 2019**, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (Zyra e Protokollit), adresa Rruga "Ibrahim Rugova" nr. 4, ose pranë Zyrave Rajonale Zgjedhore të KQZ-së dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë për shprehje interesi për t'u emëruar kryesisht nga KQZ si anëtar apo sekretar i KQV në Zonën Zgjedhore përkatëse (Bashkinë ku kanë vendbanimin). Në kërkesë të depozitohet numri telefonik i kontaktit dhe adresa e postës elektronike;
2. Certifikatë personale;
3. Kopje të diplomës së nivelit arsimor të përfunduar;
4. Vetë deklaram i nënshkruar për plotësimin e kriterëve të përcaktuara në pikat 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10. Përzgjedhja do të bëhet sipas Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV".

Shtetasi/shtetasja që emërohet kryesisht për plotësim të vakancës në KQV:

gëzon të njëjtat të drejta dhe ka të njëjtat detyrime si çdo anëtar dhe sekretar i propozuar nga partitë politike, sipas parashikimeve në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë dhe aktet

nënligjore të KQZ-së gëzon të drejtën e shpërblimit sipas përcaktimeve të Vendimit të KQZ-së nr. 37, datë 26.12.2018.

Adresat e Zyrave Rajonale Zgjedhore të KQZ-së, i gjeni në faqen zyrtare të internetit të KQZ www.cec.org.al “